



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
AUTORITETI I MBIKËQYRJES FINANCIARE
BORDI

RREGULLORE

PËR
MBAJTJEN DHE RUAJTJEN E REGJISTRAVE TË SUBJEKTEVE TË LICENCUARA,
AUTORIZUARA, NJOHURA, REGJISTRUARA DHE MIRATUARA NGA AUTORITETI
I MBIKËQYRJES FINANCIARE

Miratuar me Vendim Bordi nr. 143, datë 28.08.2024.

KREU I

Dispozita të Përgjithshme

Neni 1

Qëllimi

Qëllimi i kësaj rregullore është përcaktimi i mënyrës së mbajtjes dhe ruajtjes së regjistrave nga Autoriteti i Mbikëqyrjes Financiare (në vijim “Autoriteti”) për personat juridikë e fizik dhe fondet, të licencuar, autorizuar, njohur, regjistruar apo të miratuar si dhe informimin e publikut me këto të dhëna.

Neni 2

Baza ligjore

Kjo rregullore hartohet në zbatim të nenit 29, të ligjit nr. 9572, datë 03.07.2006 “Për Autoritetin e Mbikëqyrjes Financiare”, i ndryshuar, të nenit 219, të ligjit nr. 52, datë 22.05.2014 “Për veprimtarinë e sigurimit dhe risigurimit”, të nenit 8, të ligjit nr. 56, datë 30.04.2020 “Për sipërmarrjet e investimeve kolektive”, të neneve 8, 25, 40, 373 të ligjit nr. 62, datë 14.05.2020 “Për tregjet e kapitalit”, të nenit 7, të ligjit nr. 76, datë 06.11.2023 “Për Fondet e Pensionit Privat” dhe nenit 22, të ligjit nr. 66, datë 21.05.2020 “Për tregjet financiare të bazuara në teknologjinë e regjistrave të shpërndarë”.

Neni 3

Fusha e zbatimit

Kjo rregullore zbatohet për regjistrimin e personave juridikë e fizik dhe fondeve, të licencuar, autorizuar, njohur, regjistruar apo të miratuar nga Autoriteti, në regjistrat përkatës.

Neni 4

Llojet e regjistrave

Autoriteti, mban këto regjistra:

1. Regjistër për shoqëritë e sigurimeve;
2. Regjistër për agjentët në sigurimeve;
3. Regjistër për ndërmjetësat e tjerë në sigurime, si: shoqëritë e agjentëve, shoqëritë e brokerimit dhe brokerat;
4. Regjistër për vlerësuesit e dëmeve në sigurime;
5. Regjistër për aktuarët e autorizuar;
6. Regjistër për shoqëritë administruese të sipërmarrjeve të investimeve kolektive;
7. Regjistër për administruesit e fondeve të investimeve alternative;
8. Regjistër për depozitarët e sipërmarrjeve të investimeve kolektive;
9. Regjistër për depozitarët e fondeve të investimeve alternative;
10. Regjistër për sipërmarrjet e investimeve kolektive;
11. Regjistër për fondet e investimeve alternative;
12. Regjistër për shoqëritë administruese të fondeve të pensionit privat;
13. Regjistër për fondet e pensionit privat me pjesmarrje të hapur;
14. Regjistër për fondet e pensionit privat me pjesmarrje të mbyllur;
15. Regjistër për depozitarët e fondeve të pensionit privat;
16. Regjistër për agjentët e fondeve të pensionit privat;
17. Regjistër për shoqëritë komisionere/banka si shoqëri komisionere;
18. Regjistër për Bursën/regjistrarin e titujve/depozitarin qendror/kundërpala qendrore/shtëpi klerimi;
19. Regjistër për agjencinë e vlerësimit të rrezikut të kreditit;
20. Regjistër për platformën shumëpalëshe të tregtimit (PSHT)/platformën e organizuar të tregtimit (POT);
21. Regjistër për agjentët e lidhur;
22. Regjistër për emetuesit për oferta të titujve;
23. Regjistër për anëtarët e miratuar të Këshillit të Administrimit/Mbikëqyrës të shoqërisë komisionere;
24. Regjistër për funksionarët kryesor të certifikuar nga Këshilli i Administrimit/Mbikëqyrës i shoqërisë komisionere;

25. Regjistër për personat e skualifikuar, sipas përcaktimit në nenin 373 të ligjit nr. 62/2020 “Për tregjet e kapitalit”;
26. Regjistër për agjentët e tokenit digjital;
27. Regjistër i bursave të licencuara DLT;
28. Regjistri i Kujdestarëve të Portofolit të Palëve të Treta.

Neni 5

Mënyra e mbajtjes së regjistrave

1. Regjistrat mbahen në mënyrë elektronike për çdo subjekt.
2. Të dhënat që përmbajnë regjistrat janë të dhëna publike, me përjashtim të të dhënave që përcaktohen në nenin 40, të ligjit nr. 62/2020 “Për tregjet e kapitalit”, dhe Vendimet e Bordit të Autoritet, të cilat konsiderohen konfidenciale, sipas rregullores nr. 17, datë 28.04.2015 “Për funksionimin dhe mbajtjen e procesverbalit të mbledhjes së Bordit të Autoritetit të Mbikëqyrjes Financiare”.

KREU II

Mbajtja e regjistrave

Neni 6

Njësia përgjegjëse

Drejtoria e Licencimit, në bashkëpunim me Drejtorinë e IT, janë strukturat përgjegjëse për hostimin, mbajtjen dhe administrimin e regjistrave. Drejtori i Drejtorisë/Departamentit cakton personin/at që përgjigjen direkt për mbajtjen dhe ruajtjen e regjistrave.

Neni 7

Siguria e regjistrave elektronik të Autoritetit

Siguria e regjistrave elektronik të Autoritetit mbështetet në parimet e mëposhtme:

- a) Parimi i Ligjshmërisë - sipas të cilit, të dhënat përpunohen në një bazë të dhënash që i përket Autoritetit në përputhje me legjislacionin në fuqi dhe i përshtatur me ligjin nr. 9752, datë 03.07.2006 "Për Autoritetin e Mbikëqyrjes Financiare", i ndryshuar;
- b) Parimi i Unitetit - sipas të cilit, bazat e të dhënave duhet të jenë të afta të këmbëjnë, të ndërveprojnë dhe të verifikojnë të dhënat;
- c) Parimi i Gjurmueshmërisë - sipas të cilit, të gjitha veprimet mbi të dhënat, kohën e ndryshimit apo përditësimit të tyre, dhe çfarëdo lloj parametri tjetër teknik i ndërlidhur me to që garanton integritetin, sigurinë dhe autenticitetin si dhe veprimet e përdoruesve, administruesve, duhet

të ruhen në një sistem kontrolli në format të përshtatshëm dhe lehtësisht të lexueshëm duke ofruar mundësinë e kontrollit dhe auditimit nga instancat zyrtare përkatëse;

- d) Parimi i Përdorimit të Përditësimit Automatik të të Dhënave në Formë Elektronike - sipas të cilit përditësimi automatik në formë elektronike do të përdoren në maksimum, dhe do të prevalojë nga përditësimi manual dhe në letër, për administrimin e bazave të të dhënave. Të dhënat për aq sa është e mundur, do të përpunohen në formë digjitale;
- e) Parimi i Shkëmbimit të të Dhënave i Orientuar drejt Shërbimeve - sipas të cilit, shkëmbimi i të dhënave, ndërveprimi, midis bazave të të dhënave dhe përpunuesit të të dhënave, do të kryhet bazuar aktet ligjore dhe nënligjore në fuqi për shkëmbimin elektronik.

Neni 8

Burimi i të dhënave për regjistrin

1. Regjistrimi i të dhënave në regjistrin përkatës mbështetet në Vendimet e Bordit të Autoritetit të cilat janë objekt regjistrimi si dhe në dokumentat apo informacionin e paraqitur nga subjektet, objekt regjistrimi, sipas kësaj rregullore.
2. Regjistrimi i të dhënave në regjistrin përkatës bëhet brenda 5 ditëve pune nga data e hyrjes në fuqi të Vendimit të Bordit, apo paraqitjes së informacionit të plotë, në përputhje me aktet ligjore dhe nënligjore në fuqi.

Neni 9

Regjistri elektronik

1. Regjistri elektronik si një bazë e plotë e të dhënave krijohet pranë zyrave të Autoritetit dhe administrohet nga Autoriteti.
2. Autoriteti administron, sistemon, ruan dhe përpunon të dhënat në regjistrin elektronik, sipas kushteve të përcaktuara në aktet ligjore dhe nënligjore në fuqi, me qëllim ofrimin e shërbimeve transparente, siguri në informacionin e administruar, fleksibilitet, aksesueshmëri dhe shfrytëzim në çdo kohë të të dhënave, sipas qëllimit të legjislacionit në fuqi.
3. Regjistri elektronik, përbëhet nga komponentët e arkitekturës software dhe hardware, me karakteristikat e tyre funksionale dhe teknike.
4. Përgjegjës për mbikëqyrjen, zhvillimin, vënien në shfrytëzim, përditësimin dhe zbatimin e kësaj rregulloreje, janë personat që përgjigjen direkt për mbajtjen dhe ruajtjen e regjistrave.

Neni 10

Hedhja e të dhënave në regjistrin elektronik

1. Hedhja e të dhënave në regjistrin elektronik duhet të bëhet në mënyrë të tillë që të ketë gjurmë mbi datën e futjes së të dhënës, llojit të veprimit dhe emrin e personit që ka bërë hedhjen e të dhënës.

2. Hedhja e të dhënave të reja bëhet në mënyrë të tillë që të mos ketë ndikim mbi të dhënat e mëparshme, duke ruajtur historinë e të dhënave. Kur një e dhënë e futur anulohet, ajo nuk duhet të prekë regjistrimet përkatëse ku u bë anulimi. Anulimi nuk duhet të çojë në ndonjë humbje apo dëmtim të informacionit që futet. Çdo gabim që mund të bëhet në momentin e futjes së të dhënës, korrigjohet duke marrë më parë pëlqimin e Drejtorit të Drejtorisë. Korrigjimi nuk duhet të çojë në humbje apo dëmtim të informacionit që futet.

Neni 11

Vendndodhja e regjistrave

Regjistrat sipas kësaj rregullore mbahen pranë Autoritetit të Mbikëqyrjes Financiare.

Regjistri elektronik sigurohet nëpërmjet faqes zyrtare të internetit të Autoritetit dhe është i aksesueshëm nga publiku, i cili ka të drejtë të informohet mbi përmbajtjen e tij.

Neni 12

E drejta e informimit

1. Çdo person, mund të kërkojë informacion mbi të dhënat që përmbajnë regjistrat. Informacioni mund të kërkohet me mjete elektronike ose me shkrim.
2. Kërkesat për të marrë informacion nga të dhënat e regjistrave si dhe nxjerrja e informacionit bëhet në rrugë zyrtare, sipas urdhërit të Drejtorit të Përgjithshëm Ekzekutiv të Autoritetit.

KREU III

Ruajtja e regjistrave

Neni 13

Personi përgjegjës

Çdo veprim që lidhet me ruajtjen e regjistrave kryhet nga personi i ngarkuar për të mbajtur regjistrat.

Neni 14

Ruajtja e regjistrat elektronik

1. Të dhënat elektronike ruhen në mënyrën që të sigurohet integriteti i informacionit dhe aksesit i kontrolluar për futjen e të dhënave dhe njohjen e informacionit.
2. Kopjimi i të dhënave nga database në mjete elektronike bëhet me autorizim të Drejtorit të Përgjithshëm Ekzekutiv. Një kopje e arkivës elektronike duhet të ruhet në një vend të veçantë nga mbajtja e regjistrat, sipas urdhërit të Drejtorit të Përgjithshëm Ekzekutiv.

3. Në rastet e ndryshimeve të shpeshta në regjistrat përkatës, kopja e arkivës elektronike përditësohet në fund të çdo jave.
4. Në rastet e ndryshimeve jo të shpeshta në regjistrat përkatës, kopja e arkivës elektronike përditësohet në fund të çdo muaji.

KREU IV

Të dhënat subjekt i regjistrave

Seksioni 1

Të dhëna të përgjithshme

Neni 15

Të dhëna të përgjithshme, subjekt i regjistrave për personat juridik

Në kartelën e çdo subjekti juridik, shënohen këto të dhëna:

1. Emri i shoqërisë;
2. Data e regjistrimit në regjistër;
3. Forma ligjore e organizimit të shoqërisë;
4. Data e regjistrimit të subjektit në QKB;
5. Numri i identifikimit të shoqërisë (NUIS);
6. Selia qendrore;
7. Adresa, nr. i tel, website dhe adresa e e-mail;
8. Adresa e degëve (nëse ka);
9. Numri dhe data e licencës;
10. Objekti i licencës;
11. Afati i aktivitetit të shoqërisë;
12. Kapitali i themelimit;
13. Struktura aksionare;
14. Administratori;
15. Këshilli i Administrimit/Mbikëqyrës, drejtoria/personeli kyç/funksionarët kryesor;
16. Riorganizimi i shoqërisë (në rast bashkimi, ndarje, transformimi);
17. Masat administrative, gjobat të vendosura nga Bordi për shoqërinë dhe për individë të caktuar;
18. Shënime të tjera.

Seksioni 2

Të dhënat të veçanta për disa regjistra

Neni 16

Për regjistrat e shoqërive komisionere

Në regjistrin e shoqërive komisionere/banka si shoqëri komisionere, përveç të dhënave të përmendura në nenin 15, në pikën “objekti i licencës” do të shënohen: *“Të dhëna për shërbimet e investimit, shërbimet ndihmëse dhe instrumentat financiare, për të cilat është dhënë licenca”*.

Neni 17

Për regjistrat e Bursës

Në regjistrin e shoqërive që operojnë si Bursë, përveç të dhënave të përmendura në nenin 15, do të shënohen:

1. Emrat e shoqërive - anëtarë të Bursës;
2. Përfaqësuesit e licencuar që operojnë në treg;
3. Rregullat mbi të cilat operon tregu;
4. Emrat e shoqërive të listuara në tregun zyrtar dhe jozyrtar.

Neni 18

Për regjistrat e emetuesve të ofertave të titujve

Në regjistrin e shoqërive emetuese të letrave me vlerë shënohen këto të dhëna:

1. Emri i shoqërisë;
2. Forma ligjore e organizimit të shoqërisë;
3. Adresa, nr. i telefonit, website dhe adresa e e-mail;
4. Vlera e kapitalit aksionar;
5. Vendimi i Bordit për miratimin e prospektit;
6. Të dhëna për letrat me vlerë që do emetohen: Lloji i letres me vlerë, Madhësia e emetimit, Vlera nominale, Çmimi i ofruar;
7. Shënime të tjera.

Neni 19

Për regjistrat e shoqërive të sigurimeve

Në regjistrin e shoqërive që operojnë si shoqëri sigurimesh, përveç të dhënave të përmendura në nenin 15, në pikën “objekti i licencës”, do të shënohen: *Të dhëna për klasat e sigurimeve për të cilat është dhënë licenca.*

Neni 20

Për regjistrat e SIK, FIA dhe FPP

1. Në regjistrin e sipërmarrjeve të investimeve kolektive (SIK) si: fond investimi/shoqëri investimi/shoqëri komandite dhe fondeve të investimeve alternative (FIA) do të shënohen të dhënat:

- a. Emërtimi i sipërmarrjes së investimeve kolektive;
- b. Fond me pjesëmarrje të hapur/me pjesëmarrje të mbyllur/me interval;
- c. Fond me ofertë publike/me ofertë publike në tituj të transferueshëm;
- d. Sipërmarrje e veçantë/ombrellë, kryesore/furnizuese;
- e. Të dhëna për shoqërinë administruese;
- f. Të dhëna për depozitarin;
- g. Numrin dhe datën e licencës;
- h. Numrin dhe datën e Vendimit të Bordit.

2. Në regjistrin e fondeve të investimeve alternative (FIA) do të shënohen të dhënat:

- a. Emërtimi i fondeve të investimeve alternative;
- b. Të dhëna për shoqërinë administruese të fondeve të investimeve alternative;
- c. Të dhëna për depozitarin e fondeve të investimeve alternative;
- d. Numrin dhe datën e Vendimit të Bordit.

3. Në regjistrin e fondeve të pensionit privat (FPP), do të shënohen të dhënat:

- a. Emërtimi i fondit të pensionit privat;
 - i. Fond me pjesëmarrje të hapur;
 - ii. Fond me pjesëmarrje të mbyllur;
- b. Në rastin e një fondi me pjesëmarrje të mbyllur, edhe të dhënat për sponsorin;
- c. Të dhëna për shoqërinë administruese;
- d. Të dhëna për depozitarin;
- e. Numrin dhe datën e Vendimit të Bordit.

Seksioni 3

Neni 21

Të dhëna për regjistrin e personave fizik të licencuar apo përfaqësuesve të shoqërive të licencuara

Regjistri i personave fizik të licencuar apo përfaqësuesve të shoqërive të licencuara do të përmbajë:

1. Emrin e personit fizik të licencuar apo autorizuar;
2. Të dhëna mbi personin: emri i babait, datëlindja, arsimi;
3. Numri dhe data e lëshimit të licencës apo autorizimit;
4. Shoqërinë në emër dhe për llogari të të cilës vepron;
5. Adresa ku kryhet aktiviteti;
6. Masat administrative të vendosura nga Bordi;
7. Shënime të tjera.

Neni 22

Të dhëna për subjektet që ushtrojnë veprimtarinë e tyre në tregjet financiare të bazuara në teknologjinë e regjistrave të shpërndarë

1. Në regjistrin e shoqërive që ushtrojnë veprimtarinë e tyre në tregjet financiare të bazuara në teknologjinë e regjistrave të shpërndarë, do të shënohen:
 - a. Statusi i licencimit;
 - b. Për Bursat DLT duhet të specifikohet nëse Bursa DLT ka një licencë të kategorisë “A”, “B”, ose “C”;
 - c. Numrin e protokollit/eve dhe data/at e vendimeve të marra nga autoriteti përgjegjës që ka lëshuar licencën përkatëse;
 - d. Emrin e personit juridik;
 - e. Forma ligjore e organizimit të shoqërisë;
 - f. Numri i identifikimit të shoqërisë;
 - g. Selia qendrore;
 - h. Adresa zyrtare e e-mail-it të agjentit TD (nëse aplikohet) dhe të titullarit të licencës;
 - i. Referimin e çdo vendimi tek autoritetet përgjegjëse, nëpërmjet të cilit këto autoritete kanë ndërmarrë sanksione ndaj titullarit të licencës, në përputhje me këtë ligj;
 - j. Konfirmimin e marrjes në kohë të deklaratës së përputhshmërisë të titullarit të licencës (nëse aplikohet);
 - k. Personin e kontaktit.
2. Çdo regjistër i parashikuar në këtë nen, do të përditësohet rregullisht dhe në çdo rast, të paktën çdo 12 muaj.

Neni 23

Shënimi për licencë të kufizuar të agjentit TD

Në regjistrin e agjentëve të tokenit digjital, do të shënohet nëse subjekti kërkues aplikon për një licencë të kufizuar të agjentët TD në përputhje me rregulloren për licencimin e subjekteve që ushtrojnë veprimtarinë si agjent i tokenit digjital.

Neni 24

Çregjistrimi nga regjistrat e Autoritetit

Heqja e licencës, anulimi ose revokimi i autorizimit, miratimit apo njohjes së subjektit fizik apo juridik të licencuar, autorizuar, njohur, regjistruar apo të miratuar , shoqërohet me çregjistrim nga regjistri përkatës i Autoritetit. Të dhënat e tyre dërgohen në një regjistër të posaçëm të quajtur “Regjistri i Çregjistrimeve dhe Revokimeve”.

Neni 25

Shfuqizime

Me hyrjen në fuqi të kësaj rregulloreje, rregullorja nr. 17, datë 21.03.2007 "Për mbajtjen dhe ruajtjen e regjistrave të subjekteve të licensuara, autorizuar dhe miratuara nga Autoriteti i Mbikëqyrjes Financiare", e ndryshuar, shfuqizohet.

Neni 26

Hyrja në fuqi

Kjo rregullore hyn në fuqi menjëherë.